



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 14317 Prot.

Lezhë, më 30 . 07 . 2021

VENDIM

Nr. 114 Datë 29 . 07 . 2021

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE TË SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE
BUXHETORE PËR PBA-në 2022-2024 (Faza e dytë) TË BASHKISË LEZHË.

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjes Vendore"; dhe në zbatim të ligjit nr.68, datë 24.07.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; të Udhëzimit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore"; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi:

- 1.Miratimin e Tavanëve të Shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2022-2024 (faza e dytë) të Bashkisë Lezhë, sipas formularit të paraqitur dhe relacionit përkatës, bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
Drejtoria e Buxhetit dhe Financës

RELACION

**Mbi përgatitjen e Tavanëve sipas Programeve Buxhetore për PBA-në 2022-2024
(Faza e dytë) të Bashkisë Lezhë.**

Të nderuar këshilltarë!

Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit ka përgatitur projekt/dokumentin për tavanet e shpenzimeve sipas programeve buxhetore për PBA-në 2022-2024 për fazën e dytë, në mënyrë analitike dhe të strukturuar, bazuar në kërkesat e ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore” dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.20, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024”.

Projekt/dokumenti i tavanëve të PBA-së paraqet një prezantim të programeve buxhetore dhe nivelin e shpenzimeve sipas grup strukturës ekonomike, ku mundëson realizimin e funksioneve të veta dhe të deleguara. Projekt/dokumenti i tavanëve të PBA-së jep një informacion për programet dhe financimin e tyre për tre vitet e ardhshme 2022-2024. Në këtë projekt/dokument paraqitet në mënyrë të detajuar plani financiar i të ardhurave dhe shpenzimeve për dy vitet para të vitit buxhetor, viti buxhetor dhe tre vitet e ardhshme, sipas programeve dhe nënfunksioneve.

Në këtë fazë të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, e cila është faza teknike, merret vendimi në nivel teknik dhe buxhetor, për tavanet e qëndrueshme të shpenzimeve, të bazuar në politikën e zhvillimit, të cilat duhen respektuar në fazën finale.

Për përcaktimin e tavanëve janë marrë në konsideratë të dhënat e shpenzimeve të realizuara dhe të parashikuara për periudhën 3 vjeçare 2019-2021, të dhënat mbi të ardhurat që krijohen nga burimet e veta (taksat e tarifave), transfertat nga burimet qendrore, politikën e zhvillimit për çdo program dhe zbatimin e objektivave strategjike të miratuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor.

Bazuar në raportin e vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave ven-

dore, në transfertat e pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale për bashkinë Lezhë dhe në transfertat e kuzhtëzuara që jepen nga Qeveria Qëndrore, rezulton se burimet (të ardhurat) dhe shpenzimet janë për tre vitet e ardhshme 2022-2024 si më poshtë:

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Sipas viteve		
		2022	2023	2024
I	BURIMET	2,106,614	2,099,773	2,299,340
1	Të ardhurat vendore	706,510	782,807	811,503
2	Transferta e Pakushtëzuar	329,841	351,094	375,028
3	Transferta Sektoriale	227,590	231,180	235,270
4	Transferta e Kushtëzuar	581,180	585,670	614,955
5	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve	261,493	149,022	262,584
II	SHPENZIMET	2,091,634	2,084,069	2,283,025
III	Fondi Rezervë dhe i Kontigjencës	14,980	15,704	16,315

☞ Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore për tre vitet e ardhshme janë pasqyruar në përputhje me të dhënat e miratuara nga këshilli bashkiak me vendimin nr.28, datë 24.02.2021. Për vitin 2022 parashikohet një rënie e të ardhurave rreth 9.4 % në krahasim me parashikimin e vitit 2021; për vitin 2023 parashikohet një rritje e të ardhurave rreth 10.8 % në krahasim me vitin 2022 dhe për vitin 2024 parashikohet një rritje e të ardhurave 3.7 % në krahasim me vitin 2023.

☞ Transferta e Pakushtëzuar për vitin 2022 nuk parashikohet me rritje në krahasim me vitin 2021, në vitin 2023 parashikohet me rritje 6.44 % në krahasim me vitin 2022, dhe në vitin 2024 parashikohet me rritje 6.82 % në krahasim me vitin 2023.

☞ Transferta sektoriale ndër vite është parashikuar me rritje nga viti në vit, respektivisht : në vitin 2022 - 0.48 %, në vitin 2023 - 1.58 % dhe në vitin 2024 – 1.77 %.

☞ Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transfertat e pakushtëzuar sektoriale për periudhën 2022-2024 janë parashikuar bazuar në udhëzimin e MFE nr.7, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024” dhe në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal të miratuar nga Qeveria.

☞ Transferta e kushtëzuar, ku përfshihen fondet për Nd.Ekonomike, PAK, strehimin, gjendjen civile, QKB, fondet e akorduara për termetin, etj janë parashikuar sipas akordimeve të fondeve dhe politikave sektoriale ndër vite. Këto fonde jepen nga pushteti qendror.

☞ Krahas transfertës pakushtëzuar, sektoriale dhe të kushtëzuar për bashkinë Lezhë janë akorduar edhe fonde nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve respektivisht : për vitin 2022-261,793 mijë lekë, për vitin 2023-149,022 mijë lekë dhe vitin 2024-262,584 mijë lekë, fonde të cilat do të financojnë ndërtimin e ujësjellsave në fshatrat Zejmen, Pllanë, Markatomaj, Spiten e Tresh në Njësinë Administrative Zejmen dhe ndërtimin e ujësjellsit në zonën bregdetare të Njësisë Administrative Shënkoll.

Në përcaktimin e tavaneve buxhetore është përdorur metodologjia e buxhetimit mbi bazë programi dhe performance (BPP) duke siguruar lidhje midis burimeve publike (input-ve), produkteve, rezultateve mbi bazën e politikave e objektivave për çdo program buxhetor dhe kostove për çdo aktivitet.

Projekt/dokumenti i tavaneve buxhetore bën pasqyrimin e shpenzimeve për 9 fushat kryesore, për 23 nënfunksiione dhe për 29 programe për t'u financuar, të miratuar nga GMS-ja, ku nga 27 nënfunksiione gjithsej financohen 23 prej tyre dhe nga 36 programe gjithsej financohen 29 prej tyre.

Është bërë parashikimi i shpenzimeve për investime, ku përcaktimi i tyre është bazuar në dokumentat strategjike të bashkisë, si: PPV, Strategjitë e Zhvillimit Vendor dhe Sektorial, prioritetet e miratuara, si dhe duke respektuar kriteret prioritare dhe rregullat bazë për financimin e tyre.

Shpenzimet gjithsej paraqiten me rënie 0.3 % në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022, kjo për arsye të uljes së nivelit të financimit nga FZHR në shumën 112,471 mijë lekë.

Në lidhje me përcaktimin e tavaneve përgatitore të PBA-së 2022-2024 për fazën teknike janë mbajtur parasysh edhe këto kritere bazë, si;

☞ Angazhimet buxhetore, ku përfshihen të gjitha shpenzimet për kontratat e lidhur, siç janë shpenzimet për pastrimin, gjelbërimin, shpenzimet e varrimit, dekorin, për ushqimet dhe investimet në proces, etj.

☞ Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura të krijuara ndër vite, të parashikuara për t'u likuiduar gjatë 3 vjeçarit, respektivisht për vitin 2022-48,214 mijë lekë, për vitin 2023-44,974 mijë lekë dhe për vitin 2024-44,103 mijë lekë, gjithsej 137,291 mijë lekë. Në detyrimet e prapambetura peshën më të madhe e zënë shpronësimet e para vitit 2015 dhe detyrimet që kanë ardhur nga ish-komunat, ndërsa për vitet 2016-2020 trashëgohen detyrime minimale.

☞ Pesha e shpenzimeve kapitale me burim financimi nga burimet e veta të bashkisë janë në rritje nga viti në vit, kjo për të mundësuar përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

☞ Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore kanë pësuar rritje ndër vite 1-2 %. Në këtë strukturë ekonomike synohet rritje të pagave, duke reduktuar numrin e personelit administrativë që shërben.

☞ Shpenzimet e tjera dhe ato operative kanë pësuar rënie ndër vite, kjo jo për arsye të uljes së nivelit të financimit të tyre, por nga ndikimi që jep ulja e vlerës së detyrimeve të prapambetura të trashëguara ndër vite.

☞ Në përcaktimin e taveve të shpenzimeve një vëmendje e vecantë është treguar edhe në përcaktimin e shpenzimeve për nënprogramin e Mbrojtjes Civile, ku për tre vitet është llogaritur një fond mesatarisht mbi 48,000 mijë lekë çdo vit ose 4.3 % të buxhetit të bashkisë nga burimet e veta.

☞ Në përcaktimin e taveve të shpenzimeve buxhetore është vlerësuar edhe situata e krijuar nga pandemia, në parashikimin e të ardhurave vendore dhe shpenzimeve buxhetore.

☞ Në përcaktimin e nivelit të taveve buxhetore për fazën e dytë janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë edhe rekomandimet e dërguara nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë mbi projektdokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, të miratuar në fazën e parë.

☞ Si përfundim, në mënyrë të detajuar dhe analitike jepen Tavanet sipas Programeve Buxhetore, bashkëlidhur këtij relacioni.

Lezhë, më 15.07.2021

DREJTORI I FINANCËS DHE BUXHETIT

Brikena Vuksani



TAVANET BUXHETORE PËR PBA-së 2022-2024 PËR ÇDO PROGRAM BUXHETOR (FAZA E II-të)

Kodi	Programet	2022					2023					2024				
		600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231
		Në mijë lekë														
01110	Planifikim, menaxhim, admin.	73,134	52,106	2,000	73,865	52,150	2,000	75,348	52,222	2,000	75,348	52,222	2,000	75,348	52,222	2,000
01120	Çështje financiare dhe fiskale	35,087	4,043	0	35,171	4,043	0	35,875	4,043	0	35,875	4,043	0	35,875	4,043	0
01170	Gjendja Civile	8,397	0	0	8,397	0	0	8,397	0	0	8,397	0	0	8,397	0	0
01710	Pagesa shërbimit të borxhit	0	11,129	0	0	8,346	0	0	8,346	0	0	0	8,346	0	0	0
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	9,963	1,951	0	9,963	1,951	0	10,162	1,953	0	10,162	1,953	0	10,162	1,953	0
03280	Mbrojtja nga zjarri (MZSH)	28,392	4,304	100	28,462	4,312	10,050	29,060	4,265	0	29,060	4,265	0	29,060	4,265	0
03280	Mbrojtja civile (Em.Civile)	4,443	43,700	0	4,543	43,637	0	4,605	43,690	0	4,605	43,690	0	4,605	43,690	0
03600	Marrëdhëniet në Komunitet	0	4,158	0	0	4,241	0	0	4,325	0	0	4,325	0	0	4,325	0
04130	Mbështetja për zhvillim ekon.	1,653	190	0	1,653	190	0	1,653	190	0	1,653	190	0	1,653	190	0
04160	Shërbimi tregjeve, akred. insp.	0	0	0	0	0	24,350	0	0	0	24,350	0	0	0	0	150,000
04220	Shërb.bujqësore, inspek.siguria ushqimore,mbr.konsumatorëve.	20,359	523	0	20,766	533	0	21,180	550	0	21,180	550	0	21,180	550	0
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	8,348	14,652	0	8,348	14,652	0	8,515	14,652	0	8,515	14,652	0	8,515	14,652	0
04260	Administ.pyjeve dhe kullotave	12,996	1,903	0	12,996	1,903	0	13,257	1,903	0	13,257	1,903	0	13,257	1,903	0
04520	Rrjeti rrugor rural	28,937	48,604	293,649	28,937	48,604	297,176	29,515	48,605	189,481	29,515	48,605	189,481	29,515	48,605	189,481
04570	Transporti publik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
04740	Projekte Zhvillimi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
04760	Zhvillimi i turizmit	6,730	4,304	0	6,865	4,390	0	7,002	4,508	0	7,002	4,508	0	7,002	4,508	0
05100	Menaxhimi i mbetjeve	13,962	81,909	0	14,079	81,912	0	14,360	83,269	0	14,360	83,269	0	14,360	83,269	0
05200	Menaxhimi U.Z e Kanalizime	7,977	5,102	0	8,136	5,108	0	8,300	5,210	0	8,300	5,210	0	8,300	5,210	0
05320	Progr. për mbrojtjen e mjedisit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
05630	Ndërgjegjësimi mjedisor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
06140	Planifikimi Urban Vendor	16,738	2,982	0	16,997	3,029	0	17,340	3,030	0	17,340	3,030	0	17,340	3,030	0
06210	Programet e Zhvillimit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
06260	Shërbimet publike vendore	31,509	26,509	0	31,742	26,515	0	32,380	25,699	0	32,380	25,699	0	32,380	25,699	0
06330	Furnizimi me ujë	0	0	261,493	0	0	149,022	0	0	262,584	0	0	262,584	0	0	262,584
06440	Ndriçim rrugësh	5,672	16,441	0	5,672	16,441	0	5,785	16,445	0	5,785	16,445	0	5,785	16,445	0
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
08130	Sport dhe Argëtim	4,674	17,766	0	4,767	18,121	0	4,863	18,540	0	4,863	18,540	0	4,863	18,540	66,463
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	18,296	3,525	400	18,406	3,525	16,258	18,775	3,595	36,500	18,775	3,595	36,500	18,775	3,595	36,500
09120	Arsimi parashkollor përfshirë dhe arsimin bazë	141,103	46,243	4,093	143,756	47,143	43,155	146,462	46,562	0	146,462	46,562	0	146,462	46,562	0

09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	16,530	6,192	15,202	16,530	6,192	202	16,860	6,320	0
09240	Arsimi profesional	9,143	5,204	308	9,143	5,204	308	9,320	6,580	0
10140	Kujdesi social për PAK	6,404	499,769	0	6,434	502,938	0	6,565	528,085	0
10220	Sigurimi shoqëror	0	250	0	0	250	20,000	0	250	0
10430	Kujdesi social familje e fëmijët	18,789	75,926	0	18,892	75,926	0	19,270	86,870	0
10550	Papunësia, arsimi dhe aftësim	0	0	0	0	0	0	0	0	0
10661	Strehim Social	748	5,020	0	752	5,020	0	767	5,020	0
	TOTALI TAVANEVE	529,984	984,405	577,245	535,272	986,276	562,521	545,616	1,016,381	721,028
04910	Fondi Rezervë	0	7,490	0	0	7,852	0	0	8,158	0
04940	Fondi i Kontigjencës	0	7,490	0	0	7,852	0	0	8,157	0
	TOTALI	529,984	999,385	577,245	535,272	1,001,980	562,521	545,616	1,032,696	721,028
	TOTALI I BUXHETIT		2,106,614			2,099,773			2,299,340	